

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. BUJAR SHESHI

10/24/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 23.10.2018 për subjektin e rivlerësimit, z.Bujar Sheshi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 24.10.2018 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Bujar Sheshi, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Genta Tafa Bungo relatores, znj. Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve .

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.